



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 500/5 prot.

Datë 20.03.2024

V E N D I M
Nr. 289/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.03.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes, për pjesën e pranuar të ankesave të operatorëve ekonomikë “QuantX IT Solutions” SHPK, dhe “Blueprint Technologies” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-96506-02-27-2024, me objekt “Blerje pajisje Tik për Bashkinë”, me fond limit 5,794,043.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar, në datën 11.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës

Modifikimi i dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-96506-02-27-2024, me objekt “Blerje pajisje Tik për Bashkinë”, me fond limit 5,794,043.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar, në datën 11.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës

Ankimues:

“QuantX IT Solutions” SHPK, me NIPT M31904013D dhe me adresë: Ruga e Dibrës, Njësia Administrative Nr. 8, Vila nr.153, kati i pare, zona kadastrale nr. 8360, Tiranë.

Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, me NIPT L82428011G dhe me adresë: Njësia administrative nr. 10, Rruga “Fortuzi”, Nr.66/1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Durrës, me adresë: Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre, duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.02.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-96506-02-27-2024, me objekt “Blerje paisje Tik për Bashkinë”, me fond limit 5,794,043.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 29.02.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/3842 dhe me nr. 500/2024 prot., datë 29.02.2024, e operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me anë të shkresës nr. 1388/8 prot., datë 12.03.2024, protokolluar me tonën me nr. 500/2 prot., datë 18.03.2024 me objekt “Dërgohet vendim i Komisionit të Shqyrtimit të ankesës për procedurën me objekt: “Blerje pajisje TIK për Bashkinë Durrës”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Vendimin nr.1388/6 prot., datë 12.03.2024 të KSHA, ku konstatohet se kjo e fundit ka pranuar pjesërisht ankesën, si më poshtë:

“[...]

Komisioni i Shqyrtimit të ankesave vëren se,

1. Në lidhje me kërkesën e parë, në nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në pikën 4 të tij citohet se “Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë, duke e pranuar atë.

2. Në lidhje me kërkesën e dytë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se kriteri për punonjesit e kualifikuar është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 57 b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht, stafi prej 3 (tre) punonjeshish të kualifikuar kërkohet për arsyen në rast defekti të kete shërbimi sa me të shpejtë dhe çilesorë për gjatë kohës së mbulimit të garancisë. Vlerësojmë se një numër më i vogël personeli të kualifikuar, do të sillte mangësi dhe vonesa në ofrimin e shërbimit të garancisë.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson jo të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë, duke mos e pranuar atë.

3. Në lidhje me kërkesën e tretë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se kërkesa për ISO 20090-1 Certifikimi i Sistemit Për Menaxhimin e Shërbimeve Të Teknologjisë

Informative, duke marre ne konsiderate se certifikata ne fjale i referohet Menaxhimit te Sherbimeve te Teknologjise se Informacionit, nderkohe qe procedura ne fjale eshte procedure blerje malli, vlerëson të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë, duke e pranuar atë.

Për sa trajtuam më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës,

VENDOSI:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik QUANTX IT SOLUTIONS për procedurën “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Mall”, me numër të referencës REF-9650602-27-2024, me objekt: “Blerje pajisje TIK per bashkine”, me fond limit: 5794043 (pesë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyzet e tre) lekë, me fondet buxheti i bashkisë Durrës.

2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vijimin e procedurave të mëtejshme në zbatim të Ligjit Nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ngarkohet Njësisa e Prokurimit pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Durrës.”

II.5. Në datën 05.03.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/3867 dhe me nr. 557/2024 prot., datë 05.03.2024, e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.7. Me anë të shkresës nr. 1388/4 prot., datë 12.03.2024, protokolluar me tonën me nr. 557/2 prot., datë 18.03.2024, me objekt “Dërgohet vendim i Komisionit të Shqyrtimit të ankesës për procedurën me objekt: ‘Blerje pajisje TIK për Bashkinë Durrës’”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Vendimin nr.1388/4 prot., datë 12.03.2024 të KSHA, ku konstatohet, se kjo e fundit ka pranuar pjesërisht ankesën, si më poshtë:

“[...]

Komisioni i Shqyrtimit të ankesave vëren se:

1. Në lidhje me kërkesën e parë, në nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në pikën 4 të tij citohet se “Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimes lidhur me këtë pikë, duke e pranuar atë.

2. Në lidhje me kërkesën e dytë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se kriteri për punonjësit e kualifikuar është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 57 b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht, stafi prej 3 (tre) punonjësish të kualifikuar kërkohet për arsyen në rast defekti të kete shërbimi sa me të shpejtë dhe cilesorë për gjatë të gjithë kohës së mbulimit të garancisë. Vlerësojmë se një numër më i vogël personeli të kualifikuar, do të sillte mangësi dhe vonesa në ofrimin e shërbimit të garancisë.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson jo të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimes lidhur me këtë pikë, duke mos e pranuar atë.

3. Në lidhje me kërkesën e tretë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, referuar shqyrtimit dhe shpjegimit të dhënë për pikën 2, vlerëson gjithashtu jo të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimes lidhur me këtë pikë, duke mos e pranuar atë.

4. Në lidhje me kërkesën e katërt, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se kërkesa për ISO 20090-1 Certifikimi i Sistemit Për Menaxhimin e Shërbimeve të Teknologjisë Informative, duke marrë në konsideratë se certifikata në fjale i referohet Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, nderkohe që procedura në fjale është procedure blerje malli, vlerëson të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimes lidhur me këtë pikë, duke e pranuar atë.

5. Në lidhje me kërkesën e pestë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, për të evituar paqartësitë në radhët e ofertuesve, vlerëson të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimes lidhur me këtë pikë, duke e pranuar atë.

VENDOSI:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik BLUEPRINT TECHNOLOGIES për procedurën “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Mall”, me numër të referencës REF-9650602-27-2024, me objekt: “Blerje pajisje TIK për bashkinë”, me fond limit: 5794043 (pesë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyzet e tre) lekë, me fondet buxheti të bashkisë Durrës.

2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vijimin e procedurave të mëtejshme në zbatim të Ligjit Nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ngarkohet Njësia e Prokurimit pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Durrës.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesve për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me anë të shkresës nr. 1388/8 prot., datë 12.03.2024, protokolluar me tonën me nr. 500/2 prot., datë 18.03.2024, me objekt “Dërgohet vendim i Komisionit të Shqyrtimit të ankesës për procedurën me objekt: ‘Blerje pajisje TIK për Bashkinë Durrës’”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Vendimin nr.1388/6 prot., datë 12.03.2024 të KSHA, ku konstatohet, se kjo e fundit ka pranuar pjesërisht ankesën, si më poshtë:

“[...]

Komisioni i Shqyrtimit të ankesave vëren se,

1. Në lidhje me kërkesën e parë, në nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në pikën 4 të tij citohet se “Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. ”.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë, duke e pranuar atë.

2. Në lidhje me kërkesën e dytë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se kriteri për punonjesit e kualifikuar është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 57 b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhefose komponentët e tij. Konkretisht, stafi prej 3 (tre) punonjeshish të kualifikuar kërkohet për arsyen në rast defekti të kete shërbira sa me të shpejta dhe çilesorë për gjatë të gjithë kohës së mbulimit të garancisë. Vlerësojmë se një numër më i vogël personeli të kualifikuar, do të sillte mangësi dhe vonesa në ofrimin e shërbimit të garancisë.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson jo të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë, duke mos e pranuar atë.

3. Në lidhje me kërkesën e tretë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se kërkesa për ISO 20090-1 Certifikimi i Sistemit Për Menaxhimin e Shërbimeve Të Teknologjisë Informativë, duke marrë në konsideratë se certifikata në fjalë i referohet Menaxhimit të

Sherbimeve te Teknologjise se Informacionit, nderkohe qe procedura ne fjale eshte procedure blerje malli, vlereson te drejte pretendimin e operatorit ekonomik ankimues lidhur me ketë pikë, duke e pranuar atë.

Për sa trajtuam më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës,

VENDOSI:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik QUANTX IT SOLUTIONS për procedurën “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Mall”, me numër të referencës REF-9650602-27-2024, me objekt: “Blerje pajisje TIK per bashkine”, me fond limit: 5794043 (pesë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyzet e tre) lekë, me fondet buxheti i bashkisë Durrës.

2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vijimin e procedurave të mëtejshme në zbatim të Ligjit Nr.16272020, “Për Prokurimin Publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ngarkohet Njësisa e Prokurimit pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Durrës.”

III.1.2. Me anë të shkresës nr. 1388/4 prot., datë 12.03.2024, protokolluar me tonën me nr. 557/2 prot., datë 18.03.2024, me objekt “Dërgohet vendim i Komisionit të Shqyrtimit të ankesës për procedurën me objekt: ‘Blerje pajisje TIK për Bashkinë Durrës’”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Vendimin nr.1388/4 prot., datë 12.03.2024 të KSHA, ku konstatohet, se kjo e fundit ka pranuar pjesërisht ankesën, si më poshtë:

“[...]

Komisioni i Shqyrtimit të ankesave vëren se:

1. Në lidhje me kërkesën e parë, në nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në pikën 4 të tij citohet se “Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlereson të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë, duke e pranuar atë.

2. Në lidhje me kërkesën e dytë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlereson se kriteri për punonjësit e kualifikuar është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 57 b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose

komponentët e tij. Konkretisht, stafi prej 3 (tre) punonjeshish të kualifikuar kërkohej për arsyen në rast defekti të kete shërbimi sa me të shpejtë dhe çështje të gjithë kohës së mbulimit të garancisë. Vlerësojmë se një numër më i vogël personeli të kualifikuar, do të sillte mangësi dhe vonesa në ofrimin e shërbimit të garancisë.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson jo të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimes lidhur me këtë pikë, duke mos e pranuar atë.

3. Në lidhje me kërkesën e tretë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, referuar shqyrtimit dhe shpjegimit të dhënë për pikën 2, vlerëson gjithashtu jo të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimes lidhur me këtë pikë, duke mos e pranuar atë.

4. Në lidhje me kërkesën e katërt, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se kërkesa për ISO 20090-1 Certifikimi i Sistemit Për Menaxhimin e Shërbimeve të Teknologjisë Informative, duke marrë në konsideratë se certifikata në fjale i referohet Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, nderkohe që procedura në fjale është procedure blerje malli, vlerëson të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimes lidhur me këtë pikë, duke e pranuar atë.

5. Në lidhje me kërkesën e pestë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, për të evituar paqartësitë në radhët e ofertuesve, vlerëson të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimes lidhur me këtë pikë, duke e pranuar atë.

VENDOSI:

I. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik BLUEPRINT TECHNOLOGIES për procedurën “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Mall”, me numër të referencës REF-9650602-27-2024, me objekt: “Blerje pajisje TIK për bashkinë”, me fond limit: 5794043 (pesë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyzet e tre) lekë, me fondet buxheti i bashkisë Durrës.

2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vijimin e procedurave të mëtejshme në zbatim të Ligjit Nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ngarkohet Njësia e Prokurimit pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Durrës.”

III.1.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.4. Neni 115, pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe

vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këto pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor, për ankesat me numër ankimi elektronik A/2024/3842 dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3867 dhe me nr. 557/2024 prot., datë 05.03.2024, të operatorëve ekonomikë “QuantX IT Solutions” SHPK dhe “Blueprint Technologies” SHPK.

III.1.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK dhe “Blueprint Technologies” SHPK ku kërkojnë:

“QuantX IT Solutions” SHPK

1. Kërkesa 2:

Kërkesa:

“b.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

• 3(tre) punonjes të specializuar në fushën e IT ose Elektronikës

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikaten perkatese, kualifikimin perkatese ose licencen.”TË HIQET

“Blueprint Technologies” SHPK

2- Ne piken 2.3.b Kerkohet qe Operatori Ekonomik, te kete 3 punonjes te certifikuar IT.

Kerkesa nuk eshte ne perputhje me madhesine dhe natyren e kontrates.

Per procedurat Blerje mallra, Procedure e Hapur e Thjeshtuar VKM nuk parashikon fuqi punetore , si kriter kualifikimi. Per me teper kriteri nuk eshte ne perputhje me madhesine dhe natyren e kontrates.

Ne piken 2.2.c percaktohet qe OE qe do te kualifikohet per kete procedure duhet te kete nje xhiro minimalisht 2.000.000 leke.

Cili eshte ai biznes i vogel, qe realizon 2.000.000 leke xhiro dhe qe mundet te punesoje 3 punonjes IT. Kerkesa e mesiperme nuk eshte e mbeshtetur ne ligj, nuk justifikohet nga madhesia e procedures,dhe si e tille duhet te hiqet.

3- Ne piken 2.3.c Eshte percaktuar si kriter kualifikues qe OE ofertues duhet te kete minimalisht 3 te punesuar.

Per te njejtat arsye si ankesa ne piken 2, Kerkesa nuk eshte ne perputhje me madhesine dhe natyren e kontrates.

Per procedurat Blerje mallra, Procedure e Hapur e Thjeshtuar VKM nuk parashikon fuqi punetore , si kriter kualifikimi. Per me teper kriteri nuk eshte ne perputhje me madhesine dhe natyren e kontrates.

Ne piken 2.2.c percaktohet qe OE qe do te kualifikohet per kete procedure duhet te kete nje xhiro minimalisht 2.000.000 leke.

Cili eshte ai biznes i vogel, qe realizon 2.000.000 leke xhiro dhe qe mundet te punesoje 3 punonjes. Kerkesa e mesiperme nuk eshte e mbeshtetur ne ligj, nuk justifikohet nga madhesia e procedures,dhe si e tille duhet te hiqet.

III.1.6. Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, kapaciteti teknik pika 2.3.b dhe 2.3.c është përcaktuar si më poshtë:

- b. *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:*
- *3(tre) punonjës të specializuar në fushën e IT ose Elektronikës*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikaten perkatese, kualifikimin perkates ose licencen.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

- c. *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 3 persona.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

III.1.7. Në nenin 2 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët

ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 21 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.8. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.9. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.1.10. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorëve ekonomikë ankimes “QuantiX IT Solutions” SHPK dhe “Blueprint Technologies” SHPK mbi heqjen e kriterit të veçantë të kualifikimit “*b. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë: •3(tre) punonjes të specializuar në fushën e IT ose Elektronikës.....*” si dhe pretendimit të “Blueprint Technologies” SHPK për heqjen e kriterit: “ *c. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 3 persona.....*”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesat në fjalë shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterëve të mësipërme të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet edhe në faktin, nëse kriteret e mësipërme janë në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet, në zbatim të nenit 77 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”.

KPP vëren, se autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë që të disponojnë 3 (tre) punonjes të specializuar në fushën e IT ose Elektronikës, si dhe për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojnë një staf punonjësish prej minimalisht 3 persona, ku referuar parashtrimeve në ankesë të operatorëve ekonomikë ankimes, operatori ekonomik “QuantiX IT Solutions” SHPK kërkon heqjen e kërkesës për disponimin e 3 punonjësve të specializuar në fushën e IT ose Elektronikës, ndërsa operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK kërkon heqjen e të dyja kërkesave më sipër. Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit, përmasave të kontratës, formularit të sasisë dhe grafikut të lëvrimit, si dhe specifikimeve teknike të procedurës së mësipërme të prokurimit, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në respekt të parimit të proporcionalitetit, duhet të ulë numrin e punonjësve të specializuar në fushën e IT ose Elektronikës, si dhe numrin e stafit të punonjësve prej minimalisht 3 persona, pasi këto janë kërkesa të ekzagjeruara dhe ndikojnë në uljen e konkurrencës në radhët e operatorëve ekonomikë. Disponimi i 3 punonjësve në fushën e IT apo elektronikës është një numër i ekzagjeruar, për sa kohë objekti i prokurimit lidhet vetëm me furnizimin e pajisjeve TIK si kompjutera, printer, etj dhe jo me instalim apo mirëmbajtje të sistemeve që lidhen me teknologjinë e informacionit. Në këtë kuadër, duke e parë të lidhur me arsyetimin më sipër edhe numri i punonjësve prej minimalisht 3 persona është i ekzagjeruar referuar llojit të procedurës, objektit dhe përmasave të kontratës. Komisioni vlerëson, se autoriteti kontraktor ka tejkalluar natyrën dhe përmasat e kontratës, pasi kërkesat e mësipërme janë joproporcionale me objektin e prokurimit. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale, për realizimin me sukses të kontratës, duke evituar kushte kufizuese sikundër në rastin konkret, pasi kriteret e tilla nuk i shërbejnë qëllimit për realizimin me sukses të kontratës, por krijojnë efektin e kufizimit për pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim, duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë, që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura. Në këtë kuptim, referuar arsyetimit dhe bazës ligjore sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të kryejë modifikimin e kriterëve, duke vendosur një numër të arsyeshëm

punonjësish dhe proporcional me objektin e prokurimit, në respekt të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër, pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesave të operatorëve ekonomikë “QuantiX IT Solutions” SHPK dhe “Blueprint Technologies” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-96506-02-27-2024, me objekt “Blerje pajisje Tik për Bashkinë”, me fond limit 5,794,043.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 11.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesat e operatorëve ekonomikë “QuantiX IT Solutions” SHPK dhe “Blueprint Technologies” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të vendimmarrjes së KSHA-së dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin e Prokurimeve Elektornike.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “QuantiX IT Solutions” SHPK dhe “Blueprint Technologies” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

